


**BULETINI TREMUJOR**  
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



# TRUSTORJA

## PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	VITI	1V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-2.49%	-1.56%	3.21%	6.40%	39.14%	32.93%
BENÇMARKU*	0.08%	-0.86%	-0.31%	-0.47%	13.94%	30.89%

\*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

## PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM2 2015

### ÇMIMI I AKSIONIT:

PRILL	▲ +0.19%
MAJ	▲ +0.76%
QERSHOR	▼ -2.49%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▼ -1.56%

### KTHIMI BRUTO:

PRILL	+2.63 mln
MAJ	+9.55 mln
QERSHOR	-29.45 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	-17.27 mln

## FAKTET KRYESORE

ÇMIMI I AKSIONIT  
€1.3293

MJETET NETO NËN MENAXHIM  
€1,177,735,807.55

PENSIONE TË SHPAGUARA NË TREMUJOR  
€5.53 mln

PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT  
€11.06 mln

LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË TREMUJOR  
1,304

LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË VIT  
2,463

LLOGARI TË KONTRIBUESVE  
490,007

LLOGARI AKTIVE KËTË VIT  
260,700


KONTRIBUES TË RINJ  
7,876

KONTRIBUTE KËTË TREMUJOR  
€24.99 mln

SHËRBIME TË OFRUARA KËTË TREMUJOR  
19,398

LLOGARI TË AKTIVIZUARA NË eTRUSTI  
43,605

## ALOKIMI I MJETEVE NË FUND TË TREMUJORIT



## €38 MLN KTHIMI BRUTO NË GJYSMËN E PARË TË VITIT

Tremujori i dytë i këtij viti njohu kthim negativ nga investimet dhe kthimi bruto ishte -17.3 mln euro. Në këtë mënyrë çmimi i aksionit për këtë tremujor u zhvlerësua për -1.56% dhe ra në 1.3293 euro (TM1: 1.3504 euro). Megjithatë, për shkak të performancës tejte pozitive në TM1 (prej €54.8 mln), performanca për gjysmëvitin e parë mbeti pozitive me rritje të çmimit të aksionit me 3.21% ose me kthim bruto nga investimet prej 37.5 milionë euro. Në ndërkohë mjetet nën menaxhim vazhduan të shtohen gjatë TM2 me €9.5 mln duke arritur në rreth €1.18 miliardë. Rritja e mjeteve nën menaxhim erdhi nga kontributet e reja me €33.8 mln. Në anën tjetër gjatë TM2 u shpague për pension €4.4 mln, u mbajtën për tarifat menaxhuese (investuese dhe operacionale) €1.4 mln dhe u rifunduan €0.8 mln.

### FAKTORËT ME NDIKIM

Tregjet financiare globale ndaluan ritmin e rritjes në TM2, kryesisht për shkak se sinjalet e zhvillimit ekonomik në BE e SHBA ishin të përziera, dhe për më shumë që kriza greke filloi të dalë në sipërfaqe. Në terma të dollarit amerikan tregu global i aksioneve e mbylli tremujori në anën pozitive, por klima e përgjithshme në fund të tremujorit ishte tejte dekurajuese për investitorët, duke u vënë në pikëpyetje e ardhmja edhe e monedhës së përbashkët Euro, si pasojë e rrezikut me daljen e mundshme të Greqisë nga Eurozona. Në anën tjetër tregu global i bonove njohu rritje në normat e interesit, duke u nxitur edhe nga pritshmëritë se normat e interesit në SHBA dhe Britani mund të rriten këtë vit, në pritje edhe të mbylljes së programit të lehtësimit monetar.

### KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM2

**-1.56%**

### KTHIMI NGA INVESTIMET PËR VITIN

**+3.21%**

### PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Në ndryshim të plotë nga tremujori paraprak, TM2 ishte me performancë negative për të gjitha fondet investuese të FKPK-së. Këtë tremujor performancën negative më të lartë e kishte fondi i Tobam (-4.91%), i cili rezultoi të kishte më së shumti plasmane në Evropë dhe Azi, të cilat ishin edhe vatrat kryesore të krizës këtë tremujor (Greqia, për shkak të problemit me borxhin, dhe Kina me shitjen masive të aksioneve nga rënia e besueshmërisë së investitorëve). Gjithsesi edhe fondet e tjera (kryesisht) me përqendrim në aksione si: Nordea GSEF (-3.75%), KBI DPD (-3.13%), dhe Pictet (-2.68%) ishin edhe më të prekur nga zhvlerësimi, të ndikuara edhe nga pozicionimi i tyre gjeografik dhe shpërndarja valutore e investimeve. Investimet në Kanada dhe Australi kanë njohur humbje shtesë këtë tremujor për shkak të zhvlerësimi të fortë të valutave. Performanca e fondeve të tjera investuese ishte: Vanguard (-0.77%), Schrodors (-0.51%), BNY Mellon (-2.15%), AXA WFOI (-0.98%) dhe AXA GILB (-2.59%). Por më e rëndësishmja është se vetëm Schrodors (-0.56%) dhe Tobam (-0.08%) kishin performancë negative për gjysmëvitin e parë, ndërsa të gjitha fondet e tjera ishin në terren pozitiv. Investimet në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës për këtë periudhë kishin performancë prej 0.48%, dhe kjo gjithnjë varet nga afatet e maturimit dhe datat e investimeve të reja.

## PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT	PLASMANET	PERFORMANCA
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€355,992,994.48	-0.77%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€171,349,145.73	-2.15%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€113,878,300.05	-0.51%
Nordea	1-Stable Return Fund	€102,711,586.18	-2.27%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€97,228,265.22	-2.59%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€79,739,793.50	+0.48%
KBI	Divident Plus	€59,414,346.66	-3.13%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€55,761,311.95	-3.75%
TOBAM	Anti-benchmark WEFE hedged share class	€36,732,519.21	-4.91%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€33,284,113.93	-2.68%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€28,441,217.79	-0.98%
Alceda*	Aquila Risk Parity 7 Fund	--	-1.45%
<b>GJITHSEJ</b>		<b>€1,134,533,594.70</b>	<b>-1.56%</b>

\* I gjithë investimi në këtë fond (prej 27,368,984.34 euro) është tërhequr më 23.06.2015 dhe fitimi i realizuar ishte në vlerë prej 1,479,230.80 euro.

## BORDI DREJTUES MBAJTI MBLEDHJEN E DYTË VJETORE

Bordi Drejtues i FKPK-së ka zhvilluar në qershor mbledhjen e dytë për këtë vit. Në mbledhje Bordi, përveç se ka miratuar dhe formalizuar të gjitha vendimet e marra me e-mail mes dy mbledhjeve, ka zhvilluar edhe intervista informuese me tre nga menaxhuesit e mjeteve: Vanguard, Nordesa SRF dhe Nordea GSEF. Kjo me qëllim të informimit të drejtpërdrejt me planet dhe strategjitë e këtyre menaxherëve me fondet investuese në të cilat FKPK-ja ka plasuar mjete. Gjithashtu anëtarët e Bordit janë informuar nga menaxhuesit e mjeteve edhe për sfidat dhe rreziqet e pritshme në gjysmën e dytë të vitit, dhe për veprimet taktike për shmangien e tyre.

Përveç këtyre, Bordi në këtë mbledhje vendosi edhe për tërheqjen e plotë të investimit nga fondi i Aquila Risk Parity 7 Fund (prej 27.4 milionë euro). Bordi kishte pritur që ky fond do të kishte performancë më të mirë në investime, për të arsyetuar tarifat menaxhuese relativisht më të larta sesa fondet e tjera. Nga tërheqja e këtij investimi FKPK-ja ka realizuar fitim prej 1,479,230.80 euro.

Ndër vendimet e radhës të Bordit në këtë mbledhje ishte edhe pjesëmarrja në dy ankandet e radhës të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, shuma e saktë e të cilave do të përcaktohej pas shpalljes së njohimit.

Po në këtë mbledhje Bordi vendosi të rishpallë konkursin për pozitën e Zyrtares për Investime dhe Risk (IRO), proces i cili do të duhet të kryhet gjatë muajit korrik.

Në fund, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi performancën e përgjithshme investuese të bazuar në strategjinë aktuale, Bordi miratoi vazhdimin e saj.

## U FINALIZUAN RAPORTI VJETOR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR 2014-N

Raporti Vjetor dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2014 janë finalizuar publikuar në uebfaqe dhe mund të vizitohen në vegën vijuese: <http://trusti.org/index.php/sq/raportet>.

Në publikim janë prezantuar të dhënat më të rëndësishme për (kryesisht) dy vjetët e fundit, ndërsa disa nga të dhënat më të rëndësishme edhe për pesë vjetët e fundit. Sikurse zakonisht, kopje fizike të këtij raporti i janë dërguar institucioneve më të rëndësishme të vendit, por edhe ambasadave, instituteve, OJQ-ve dhe bizneseve. Po ashtu në seancën e 10 korrikut 2015 Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Raportin Vjetor të FKPK-së për vitin 2014.

## PËRFUNDOI KONKURSI PËR ANËTARË TË BORDIT

Më 10 prill 2015 është mbyllur konkursi për përzgjedhjen e 5 anëtarëve të Bordit: 4 profesionalë dhe 1 përfaqësues i punëmarrësve. Për këtë pozitë kanë konkurruar 67 kandidatë, dhe FKPK-ja menjëherë pas mbylljes së konkursit ia ka dërguar BQK-së listën e plotë të kandidatëve, përfshirë të gjitha dokumentacionet e bashkëngjitura.

Në fazën tjetër Komisioni Përzgjedhës (në përbërje: Guvernatori i BQK-së, Ministri i Financave dhe Auditori Gjeneral) ia dërgojnë Kuvendit të Kosovës një listë me kandidatët më të vlerësuar, nga e cila listë Kuvendi me votim emëron ose riemëron 5 anëtarët e Bordit Drejtues për një mandat trevjeçar. Për kujtim, mandati i 5 anëtarëve aktualë skadon në korrik, dhe meqë emërimi/zëvendësimi i tyre nuk është bërë në afat, Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës e përcakton që mandati i tyre zgjatet automatikisht edhe për 3 muaj (deri në fund të tetorit). Në rast se deri atëherë Kuvendi nuk emëron/riemëron anëtarët e Bordit Drejtues, ky organ më pas nuk do të ketë minimumin e nevojshëm (prej katër anëtarësh) për të marrë çfarëdo vendimi.

## €5.5 MLN PENSIONE TË SHPAGUARA EDHE NË TM2

Pensionet e shpaguara në TM2 ishin në vlerë pothuajse identike me TM1 (prej 5.5 mln) duke bërë që vlera e përgjithshme e mjeteve të shpaguara në gjysmëvitin e parë të tejkaloi shifrën e 11 mln. Për të njëjtën periudhë të një viti më parë (gjysmëviti 2014) kjo shumë ishte rreth 8 mln, ose për 38% më pak.

Për të njëjtat periudha numri i kontribuuesve të pensionuar është rritur për 27% (nga 2,429 në 3,095). Për gjysmën e parë të vitit për pensionim moshe ishin 2,530 (ose 82%), raste të vdekjes ishin 429 (ose 14%) dhe raste të invaliditetit 136 (ose 4%).

Sa i përket bilancit mesatar të llogarive në fund të gjashtëmujorit, për llogaritë aktive është rritur për 15% në 3,295 euro (30.06. 2014: 2,871 euro) ndërsa për të gjitha llogaritë ekzistuese është rritur për 9% në 2,088 euro (30.06.2014: 1,920 euro).



## 4% MË SHUMË SHËRBIME NË TM2

Numri i shërbimeve të ofruara nga zyra e FKPK-së shkoi në 19,398 (nga 18,680 në TM1), ose një rritje me 4%. Ky ritëm është ndjeshëm më i ulët sesa 21% që ishte më TM1, por njëherësh është pjesë e ciklit të zakonshëm të lëvizjes së shërbimeve, ku tremujori i parë dominon me kërkesë të kontribuuesve për pasqyrat e llogarive. Krahësuar me një vit më parë (TM2/2014) numri i shërbimeve është shtuar për 52%.

Tri shërbimet më të kërkuara këtë tremujor ishin: shtypja e pasqyrave (47%), aktivizimi i shërbimit eTrusti 14%, dhe ndryshimi i adresave (7%). Në anën tjetër numri i vetëshërbimeve përmes eTrustit ra në 1,930 (TM1: 2,620), dhe ulje pësuan edhe shërbimet në zyrat rajonale të ATK-së ranë në 9,851 (TM1: 11,385).

Në total për TM2 u shërbyen ose vetshërbyen 31,179 kontribuues që përbënin 12.0% e kontribuuesve aktivë (TM1: 32,808 shërbime sa 13.5% e kontribuuesve aktivë).

## 8% MË SHUMË PËRDORUES TË e-TRUSTIT

Numri i kontribuuesve që e kanë aktivizuar shërbimin e-Trusti arriti në 43,605 në fund të TM2 (TM1 2015: 40,810 përdorues), një rritje kjo prej 8% për tre muaj. Këto ritme të rritjes së numrit të përdoruesve janë përafërsisht të njëjta me TM1 2015 prej 10% (por edhe me TM2 2014 po me 10%).

Ndërsa brenda një viti (TM2 2014 deri TM2 2015) numri i përdoruesve është me një ritëm mjaft të kënaqshëm prej 29% (nga 33,754 në 43,605).

Në fund të TM2 numri i llogarive të aktivizuara në eTrusti përbënte 8.9% të totalit të llogarive në FKPK (prej 490,007).

**BOTUES:**

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës  
Korrik 2015

**REDAKTOR:**

Vërshim Hatipi

**AUTOR:**

Jeton Demi

**KONTAKT:**

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10,  
10000 Prishtinë

038-244-341

[info@trusti.org](mailto:info@trusti.org)

[www.trusti.org](http://www.trusti.org)